

Konferenca e Rektorëve e Republikës së Kosovës

NR. PROT. 05
DATË: 25.9.2025

MARRËVESHJE SHUMËPALËSHE E BASHKËPUNIMIT

në mes të

Institucioni	Përfaqësuesi
Universiteti i Prishtinës	Prof. Arben Hajrullahu, rektor
Universiteti „Ukshin Hoti”, Prizren	Prof. dr. Asoc. Mentor Alishani, rektor
Universiteti „Haxhi Zeka”, Pejë	Prof. dr. Armand Krasniqi, rektor
Universiteti „Isa Boletini”	Prof. dr. Nyrtene Deva, rektore
Universiteti „Kadri Zeka”, Gjiilan	Prof. dr. asoc. Artan Dërmaku, rektor
Universiteti „Fehmi Agani”	Prof. dr. ass. Drilon Bunjaku, rektor
Universiteti i Shkencave të Aplikuara, Ferizaj	Prof. dr. Agron Bajraktari, rektor
Kolegji Publik Ndërkombëtar i Biznesit në Mitrovicë (IBCM)	Prof. dr. Mihone Kerolli-Mustafa, rektore

Më tutje të referuara si „Palët”

Me dëshirën për të promovuar dhe thelluar bashkëpunimin akademik, shkencor-kërkimor, arsimor dhe kulturor ndërmjet institucioneve publike të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës (*në vijim IAL-të*), palët nënshkruajnë këtë marrëveshje bashkëpunimi, duke përcaktuar përmbajtjen, kushtet dhe afatet për realizimin e saj. Kjo aktmarrëveshje zhvillohet në kuadër të bashkëpunimit institucional dhe nëpërmjet Konferencës së Rektorëve të IAL-ve publike të Republikës së Kosovës, me synim të lehtësojë dhe thellojë më tej avancimin e marrëdhënieve ndëruniversitare. Njëkohësisht, shqyrtohen mundësitë dhe iniciativat e veçanta të bashkëpunimit që ofrojnë përfitime të ndërsjella për të gjitha palët e përfshira.

Neni 1

Qëllimi i bashkëpunimit

- Qëllimi i kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi është i frymëzuar nga nevoja për të rritur mundësitë në funksion të fuqizimit e të ndërtimit të modaliteteve për zhvillim të avancuar akademik, mësimdhënie dhe mësimnxënie moderne, në baza të parimeve të digjitalizimit dhe inteligjencës artificiale, të bashkëpunimit shkencor, ndërkombëtarizimit, gjegjësisht të të gjitha veprimtarive të mishëruara në tri misionet themelore universitare. Palët nënshkruese angazhohen të krijojnë një partneritet të qëndrueshëm dhe të frytshëm në fushat profesionale, arsimore dhe shkencore.
- Ky bashkëpunim ka për qëllim të analizojë dhe të nxisë përfshirjen e të gjitha programeve të studimit që organizohen dhe ofrohen nga palët përkatëse, si dhe të promovojë hulumtimin dhe

- kërkimin shkencor, publicistik, etj., për të siguruar dhe për të eksploruar mundësi të reja për interesin e studentëve, profesorëve, shkencëtarëve dhe ekspertëve në fushat përkatëse.
3. Përmes këtij partneriteti, synohet forcimi dhe thellimi i mëtejshmë i lidhjeve ndëruniversitare, rritja e mundësive për shkëmbimin e dijes dhe përvojave, si dhe promovimi i projekteve të përbashkëta kërkimore dhe zhvillimore, që kontribuojnë në avancimin e arsimit dhe shkencës në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Neni 2

Fushat e bashkëpunimit

Bashkëpunimi ndërmjet palëve do të realizohet nëpërmjet, por nuk mund të jetë i kufizuar, veprimtarive të mëposhtme:

- a) Lehtësimin e shkëmbimit të mësimdhënësve ndërmjet palëve, në përputhje me aktet e brendshme, procedurat dhe/apo konkurset e përcaktuara në dispozitat ligjore në fuqi;
- b) Institucionalizimin, respektivisht komunikimin me të mirë ndërmjet palëve me rastin e shkëmbimit të personelit akademik nëpërmjet lejeve të veçanta;
- c) Rritjen e shkëmbimit të studentëve ndërmjet pjesëmarrjes në programe të IAL-ve, në përputhje me aktet ligjore ndërkombëtare, kombëtare dhe universitare;
- d) Rrjetëzimin dhe bashkëpunimin ndërmjet zyrave të karrierës;
- e) Bashkëpunimin, unifikimin e dokumentacionit dhe trajnimin e personelit të zyrave të ECTS-së;
- f) Bashkëpunimin dhe eventualisht ndihmën nëpërmjet qendrave të ekselencës;
- g) Rritjen e bashkëpunimit të personelit akademik dhe kërkimor, studentëve dhe personelit tjetër në projekte hulumtuese e kërkimore, ligjërata, vizita studimore dhe shkëmbimin e përvojave;
- h) Pjesëmarrjen në aktivitete të përbashkëta për aplikim në fonde të dedikuara për arsimin, kërkimin dhe aktivitetet artistike;
- i) Organizimin e përbashkët të konferencave, simpoziumeve, kongreseve, seminareve, kurseve, ngjarjeve artistike, universiteteve verore e dimërore ndërkombëtare, si dhe formave të tjera të bashkëpunimit me interes të përbashkët;
- j) Shkëmbimin dhe mundësisht dhurimin e literaturës profesionale, teksteve mësimore dhe publikimeve të tjera akademike;
- k) Shkëmbimin e informacioneve në fushat me interes për të gjitha palët;
- l) Organizimin e programeve të përbashkëta të studimit në të gjitha nivelet;
- m) Zhvillimin e programeve të veçanta akademike afatshkurta;
- n) Ofrimin e ndihmës së ndërsjellë me personel kompetent administrativ për zbatimin e konkurseve për zgjedhjen/emërimin e shërbyesve të lartë publikë/administrativë, në bazë të Ligjit për Zyrarët Publikë dhe akteve tjera ligjore në fuqi;
- o) Aktivitete të tjera me interes të përbashkët.

Neni 3

Nismat e veçanta

1. Palët, sipas interesit që kanë, mund të bien dakord të bashkëpunojnë për të eksploruar opsione dhe për të punuar në krijimin e nismave të veçanta të mëposhtme:
 - a) për të themeluar një konsorcium kërkimor dhe mësimor, i cili angazhohet në sferën e hartimit të projekteve të përbashkëta universitare dhe aplikimin në fonde vendore e ndërkombëtare;
 - b) për të analizuar mundësitë dhe strategjitë e përbashkëta për t'iu përshtatur më lehtë dhe më mirë proceseve të financimit të IAL-ve publike, në bazë të performancës;
 - c) për të themeluar një grup pune për të analizuar mundësitë e profilizimit të IAL-ve publike në Republikën e Kosovës;
 - d) për të hartuar një strategji të përbashkët për ndërkombëtarizim;
 - e) për të avancuar sistemin e menaxhimit universitar (SMU), në frymën moderne të orientuar drejt inteligjencës artificiale;
 - f) për të ndërmarrë nisma të tjera, të cilat nga palët konsiderohen të veçanta.

Neni 4

Implementimi i aktiviteteve

1. Kushtet dhe mënyra e bashkëpunimit, në mënyrë më specifike për secilën nga pikat e lartpërmendura që do të zbatohen në kuadër të kësaj marrëveshjeje, do të diskutohen dhe do të formalizohen me shkrim përpara fillimit të çdo aktiviteti konkret. Bashkëpunimet e mbështetura në këtë marrëveshje do të përcaktohen në detaje në protokolle të veçanta, të cilat do të nënshkruhen pasi njësitë brenda universiteteve të kenë përcaktuar detajet e marrëveshjes në praktikë dhe më pas do të nënshkruhen nga përfaqësuesit e autorizuar të secilës palë;
2. Aktivitetet e caktuara, të përshkruara në këtë marrëveshje, në varësi të fushës specifike dhe interesit që mund të kenë palët, mund të zbatohen edhe vetëm nga dy ose më shumë IAL, që janë palë;
3. Në rastin e përcaktuar në nenin 4, pika 4, dispozitat e një marrëveshjeje të tillë nuk i obligojnë palët tjera.

Neni 5

Zbatimi i marrëveshjes

1. Asgjë në këtë marrëveshje nuk do të cenojë autonominë e plotë të secilës palë dhe asnjë kufizim nuk do të vendoset nga njëri institucion mbi tjetrin në zbatimin e marrëveshjes.
2. Palët bien dakord që të gjitha marrëveshjet, të cilat në mënyrë ekskluzive kanë natyrë gjegjësisht implikime financiare, të nevojshme për zbatimin e kësaj marrëveshjeje, paraprakisht duhet të negociohen dhe do të varen ekskluzivisht nga disponueshmëria e fondeve përkatëse dhe nga miratimi paraprak i Këshillave Drejtuese të IAL-ve përkatëse.
3. Asnjëra palë nuk do të ketë detyrim financiar ndaj palëve tjera në bazë të kësaj marrëveshjeje.

Neni 6

Modalitetet e zbatimit

1. Palët, në kuadër të Konferencës së Rektorëve, do të themelojnë një komision të përbashkët bashkëpunimi, i cili do të mbikëqyrë zbatimin e kësaj marrëveshjeje dhe do të propozojë aktivitete konkrete.
2. IAL-të publike (palë në këtë marrëveshje), sipas nevojës dhe mundësive, do të ndërmarrin hapa të përbashkët për sigurimin e fondeve dhe burimeve financiare për realizimin e projekteve të dakorduara më sipër.
3. Për secilën fushë specifike të bashkëpunimit, qofshin ato dypalëshe ose shumëpalëshe, do të hartohen marrëveshje të veçanta zbatuese, të cilat do të përmbajnë detaje për implementimin e objektivave të përcaktuara në këtë marrëveshje.

Neni 7

Vlefshmëria e marrëveshjes

Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit nga përfaqësuesit e secilës palë dhe mbetet në fuqi për periudhën pesë (5) vjeçare nga data e nënshkrimit nga të gjitha palët.

Neni 8

Amendimet e marrëveshjes

Kjo marrëveshje e bashkëpunimit mund të shtyhet në afat apo amendohet në pjesë të veçanta të saj, me kusht që të gjitha palët të bien dakord për ndryshimet përkatëse.

Neni 9

Përfundimi i marrëveshjes

Kjo marrëveshje mund të përfundojë edhe përpara afatit të caktuar me iniciativën e ndonjërës palë, duke njoftuar me shkrim të gjitha palët e tjera, të paktën dymbëdhjetë (12) muaj përpara datës së përfundimit të propozuar.

Neni 10

Dispozitat përfundimtare


1. Palët zotohen se do të angazhohen që bashkëpunimi të zhvillohet në frymën e respektit reciprok dhe barazisë institucionale e akademike.
2. Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë gjatë zbatimit të kësaj marrëveshjeje do të zgjidhet përmes dialogut dhe dakordimit të ndërsjellë ndërmjet palëve.

Neni 11

Kjo marrëveshje bashkëpunimi është hartuar në tetë (8) kopje origjinale dhe secila palë do të mbajë nga një (1) kopje.

Nënshkruar në Prishtinë – Universiteti i Prishtinës, më 25.09.2025, në tetë kopje të barasvlershme në gjuhën shqipe, ku secila palë nënshkruese e mban një kopje.

Universiteti dhe pala nënshkruese	Nënshkrimi dhe vula
 Universiteti i Prishtinës Prof. Arben Hajrullahu, rektor	
 Universiteti „Ukshin Hoti” Prizren Prof. dr. Asoc. Mentor Alishani, rektor	
 Universiteti „Haxhi Zeka” Pejë Prof. dr. Armand Krasniqi, rektor	
 Universiteti „Isa Boletini” Prof. dr. Nyrtene Deva, rektore	
 Universiteti „Kadri Zeka” Gjilan Prof. dr. Asoc. Artan Dërmaku, rektor	

 Universiteti „Fehmi Agani” Prof. dr. Asst. Drilon Bunjaku, rektor	
 Universiteti i Shkencave të Aplikuara, Ferizaj Prof. dr. Agron Bajraktari, rektor	
 Kolegji Publik Ndërkombëtar i Biznesit në Mitrovicë (IBCM) Prof. dr. Mihone Kerolli-Mustafa, rektore	

 REPUBLIKË E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË		UNIVERSITETI "MAXHI ZEKU" PEJE 	
REKTORATI			
Nr. / Nr. / No. <u>3156</u>		Nr. /faq/ Nr. str / No. pg <u>6</u>	
Data / Data / Date: <u>12.12.2025</u> Fajle / Doc			

